



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 691/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese e panelit, Afijete Sada - Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e Hisen Berisha nga Gjakova, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuar apelet Anr.691/2021, Anr.692/2021, Anr.693/2021, Anr.694/2021 dhe Anr.695/2021 të datës 05.03.2021, të paraqitura nga Hisen Berisha nga Gjakova, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Hisen Berisha ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.691/2021 me të cilat pretendon se nga deklaratat e mbështetësve të tij mungojnë votat në vendvotimet në komunën e Istogut nr. 0619C/02D, në apelin Anr.692/2021 thekson se sipas dëshmitareve që kanë votuar nuk figurojnë votat që i kanë dhënë për kandidatin në fjalë në vendvotimin nr.0230C/01D, ndërsa në apelin Anr.693/2021, ankuesi pretendon se qendrën e votimit 0306E/01R, ka pasur ndërhyrje me laps kimik në përmirësim të numrit të votave rreth 30% të kandidatëve, në apelin Anr.694/2021 ankuesi thekson se në qendrat e votimit në komunën e Ferizaj ka pasur shumë mbështetës dhe votues që beson që e kanë votuar mirëpo nga rezultati i KQZ-së nuk del numri i votave dhe beson se është bërë devijim nga komisionerët dhe kërkon që të bëhet rinumërimi i të gjitha kutive të votimit në komunën e Ferizaj dhe apeli Anr.695/2021, në të cilin thekson se në komunën e Skenderaj në qendrat e votimit 2125b/02D, 2114b/02R, 2112b/01R, 2122b/01D, 2125b/01R, 2115/03/03D, pas numërimit është dëshmuar që qëllimisht komisionerët kanë devijuar vullnetin qytetar duke iu vendosur me shumë vota për kandidatët e listës së PDK-së, nr 10,11,12,50, duke krijuar avantazh në vota brenda listës, dhe duke dëmtuar kandidatët tjerë, dhe kërkon rinumërimin e të gjitha kutive të votimit në komunën e Skenderajit.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelet vlerësoi se:

Apelet janë te pabazuara

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Hisen Berisha i subjektit politik PDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.691/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.